



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0546

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) GEO & LAND SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Kuvendi Komunal - Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i të dhënave për infrastrukturën publike dhe ndërtimi i webgis-it për Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1, me 17/11/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE GEO & LAND SH.P.K. me nr. 2023/0546, e datës 04/08/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi Komunal - Rahoveclidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i të dhënave për infrastrukturën publike dhe ndërtimi i webgis-it për Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik GEO & LAND SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.05.2023, Kuvendi Komunal - Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Digjitalizimi i të dhënave për infrastrukturën publike dhe ndërtimi i webgis-it për Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1. Ndërsa me datën 20.07.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 124,000.00 €.

Me 25.07.2023, OE GEO & LAND SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 25.07.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE GEO & LAND SH.P.K., me nr. 546/23 lidhur me aktivitetin “Digjitalizimi i të dhënave për infrastrukturën publike dhe ndërtimi i webgis-it për Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues GEO & LAND SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankuesi pretendon se “AK gjegjësisht komisioni i vlerësimit së bashku me zyrtarin e prokurimit kanë shkelur LPP, nenin 59.4 për shkak se nuk kanë vlerësuar drejt tenderin ndaj kërkesave dhe dëshmime minimale të kërkuara. Shihet qartë se kërkesa për “1.3 Zhvillues Front-end WebGIS, Bachelor i Diplomuar në Shkenca Kompjuterike, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit” nuk kërkon fare që ekspert të jetë i certifikuar për ndonjë trajnim përkatës, sikurse që nuk kërkohet tek kërkesa “1.4. Faqe 5 of 9 Ekspert për Gjeodezi, Bachelor i Diplomuar në Gjeodezi, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit”. Andaj, ne si OE nuk kemi dorëzuar certifikata për këto dy pozita. Në lidhje me kërkesën për ekspert të certifikuar, këto janë shumë qartë të paraqitura në FTD.”

Pretendimi i dytë (II): Ankuesi pretendon se “AK mbështetur në LPP, neni 72, ka mundësinë të bëjë kërkesë tek OE që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohorë. Me këtë rast AK nuk ka bërë asnjë kërkesë tek ne si OE. Si dhe Arsyeimi i AK është fare i pabazë, dhe AK qëllimisht ka interpretuar gabim nenin 72.3, për shkak se certifikata si dokument që dëshmon për ndonjë trajnim të ndjekur, lëshohet në kohë të caktuar dhe në të shkruhet kush e ka lëshuar dhe data kur është lëshuar, rrjedhimisht ekzistenca e tyre është e fiksuar dhe mund të verifikohet fare thjesht në mënyrë objektive. Provë: dy certifikatat e dorëzuara për ekspertët në pozitën 1.1 (z. Durim Cesko) dhe 1.2 (z. Enes Haxhihamza).“

Pretendimi i tretë (III): Ankuesi pretendon se “janë OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, duke qenë se OE tjetër GEOCAD Group sh.p.k i cili ka ofertuar me çmimin e poentuar 571.30 € nuk plotëson kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, gjegjësisht pozitën 1.2 Bachelor i diplomuar në gjeografi me përvojë min. 3 vite pas diplomimit.”

Pretendimi i tretë (IV): Ankuesi pretendon se “Bazuar në LPP, nenin 35, paragrafi 2.4, del se ndryshimi i vetëm që mund të bëhet është 10% e shumës së përgjithshme të kontratës. Andaj, konstatimi i AK se çmimi jonë i ofertuar në fund arrin në vlerën 249,863.00 € është krejtësisht absurd dhe si i tillë nuk qëndron. Si i tillë, përbën shkelje të LPP, nenit 59.4, për shkak se AK vlerëson tenderin tonë jashtë kërkesave minimale të dosjes së tenderit. Ndërsa, sa i përket sasive të paraqitura të Faqe 9 of 9 AK në listën e përshkrimit të çmimeve, kjo është përgjegjësi ekskluzive e AK dhe nuk ka të bëjë me ne si OE. Në këtë rast, rekomandojmë që OSHP, gjegjësisht Eksperti Shqyrtues ta pyes AK, se nëse i ka ditur sasitë për pozicionin 1 dhe 2 të paraqitura në listën e çmimeve, siç po pretendon tani, pse nuk i ka paraqitur si të tilla kur e ka shpallur këtë tender?”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE GEO & LAND SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 17, 59.4, 72.1, 72.3 të LPP dhe shkeljet e dispozitave të nenit 40.12 të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 07/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 546/23, ndërsa me datë 21/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0546 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE GEO & LAND SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0546 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i bazuar pasi që “*Eksperti shqyrtues sqaron se përderisa AK në dosje të tenderit për stafin profesional, pika 1.3 dhe 1.4 përkatësisht për Zhvilluesin e Front-end WebGIS dhe Ekspertin për Gjeodezi nuk ka kërkuar që të jenë të certifikuar në fusha të caktuara si në rastet më para (pika 1.1 dhe 1.2), një kërkesë e tillë nuk mund të përdoret nga AK si një arsye për të eliminuar OE, për kërkesa të cilat nuk janë përfshirë në dosje të tenderit.*”

Pretendimi i dytë (II) ankimor është i bazuar pasi që “*Sipas pretendimit të dytë të ngritur nga OE ankues, ekspertit shqyrtues edhe njëherë vlerëson se duke u bazuar në karakteristikat teknike dhe ato profesionale të stafit në dosje të tenderit, Autoriteti Kontraktues nuk ka cekur se stafi profesional nga pika 1.3 dhe 1.4 duhet të kenë edhe certifikata në fushat përkatëse, andaj eliminimi i OE ankues për shkak të kërkesave të cilat nuk janë përfshirë fare përmes dosjes së tenderit është i gabuar. Së dyti vlerësojmë se edhe nëse dosja e tenderit do të kishte pasur kërkesa për certifikimin e stafit te fushat përkatëse, një eliminim direkt i OE nga ana e AK pa kërkuar sqarime shtesë sa i përket këtyre certifikatave po ashtu nuk është në përputhje me nenin 72, të LPP-së.*”

Pretendimi i tretë (III) ankimor është i bazuar pasi që “*Mendimi i ekspertit shqyrtues është se në momentin kur AK ka ditur saktë sasinë për km dhe m’ për pozicionin 1 dhe 2 në Listën e çmimeve, përkatësisht sasinë për rrugët dhe trotualet të cilat duhet të digjitalizohen, është dashur që sasinë e njohura të vendosen edhe në dosje të tenderit por edhe në listë të çmimeve ashtu siç e thotë edhe neni 9 i LPP-së dhe jo të vendoset sasia 1 si në rastin kur AK nuk mund të planifikoj sasinë e sakta për një shërbim të caktuar. Eksperti shqyrtues konsideron se AK në këtë rast ka bërë shkelje të nenit 8 dhe 9 të LPP-së sa i përket planifikimit të prokurimit dhe përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, përkatësisht pika 1 ku thuhet se: “**Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t’i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtësore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar.**”*

Pretendimi i katërt (IV) ankimor është i bazuar pasi që “*Eksperti shqyrtues në pretendimin e ngritur nga OE ankues sa i përket sasive për pozicionet 1 dhe 2 në listën e çmimeve, e vlerëson të bazuar. Duke marrë parasysh nenin 8 dhe 9 të LPP-së ku thuhet se AK duhet të planifikoj aktivitetin e Prokurimit si dhe duhet të përcaktoj nevojat që duhet përmbushur, në rastin në fjalë AK edhe pse ka ditur saktë për sasinë (km/m’) për rrugët dhe trotualet të cilat duhet të digjitalizohen ashtu siç e ka cekur në kërkesën për rishqyrtim, ato nuk i ka paraqitur edhe në dosje të tenderit dhe listën e çmimeve ashtu siç e parasheh edhe Ligji për Prokurim Publik. Përderisa në kërkesën për rishqyrtim AK ka pranuar faktin se e di saktë se sa km/m’ rrugë/trotuare ka komuna e Rahovecit të cilat duhet të digjitalizohen dhe madje ka cilësuar çmimet e vendosura nga OE ankues si shumë të larta, mendimi i ekspertit shqyrtues është se AK ka bërë shkelje të nenit 8 dhe 9 në momentin kur ka ditur saktë sasinë e pozicionit 1 dhe 2 dhe të njëjtat nuk i ka vendosur as në dosje të tenderit dhe as në listën e çmimeve ashtu siç e kërkon edhe LPP.*

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues GEO & LAND SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe

dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ia fal besimin të gjeturave të ekspertit shqyrtues dhe ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal - Rahovecit datës 20.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Digjitalizimi i të dhënave për infrastrukturën publike dhe ndërtimi i webgis-it për Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit 623-23-5382-2-2-1., ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP nisat gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin 1 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - GEO & LAND SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: